



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Lezhë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2022

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

16/06/2022

Drejtuar: OE “A l b G a r d e n” Shpk, me adrese Lagjja “Skenderbeg”, godine private 1 kateshe ne superstraden Lezhe - Shkoder, km-1, Lezhe.

Procedura e prokurimit/lotit: “E Hapur e thjeshtuar/ Mallra”.

Numri i procedurës/ referenca e Lotit: REF-30657-05-24-2022.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje fidanesh per pyllezim, peme dhe lule per gjelberim”.

Kohëzgjatja e kontratës: 20 dite nga data e nenshkrimit te kontrates.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “A L B G A R D E N” SH.P.K, me Nuis K37513520N dhe me oferte ekonomike 3,185,058 (tre milion e njeqind e tetedhjte e pese mije e pesedhjte e tete) Lek pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik “FLORAL” SH.P.K, me Nuis J68319510L dhe me oferte ekonomike 3,042,390 (tre milion e dyzet e dy mije e treqind e nentedhjte) Lek pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik “LURIMI” SH.P.K me Nuis J68403912U dhe me oferte ekonomike 3,033,880 (tre milion e tridhjte e tre mije e teteqind e tetedhjte) Lek pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**I- Operatori Ekonomik “FLORAL” SH.P.K, me Nuis J68319510L.**

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Nuk ploteson kriterin 2.3.1 të kushteve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se:

*“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

*Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

*a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate;*

*ose*

*b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur **faturat tatimore të shitjes** ku shënohen mallrat, shumat dhe vlerat”.*

Ne nenin 40, pika 3 dhe 4, e VKM-se nr. Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

#### **Neni 40, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”**

*3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

*4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.*

Nga verifikimi në SPE, rezulton se për plotësimin e këtij kriteri, OE ka paraqitur fatura tatimore blerje mallrash, ku nga verifikimi i tyre rezulton që OE “FLORAL” SH.P.K të jete pale blerese, ndersa furnizuesi (shitesi) është operator ekonomike tjetër (pale e trete), që ska lidhje me procedurën e prokurimit.

---

Sa me lart duke gene se per te permbushur kete kriter, *Operatorët ekonomik do ta vërtetojnë duke paraqitur faturat tatimore te shitjes ku shënohen mallrat, shumat dhe vlerat*, ky kriter konsiderohet i permbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 76, pika 3/a dhe ne nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar ne nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e Operatorit Ekonomik “FLORAL” SH.P.K, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

***Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “FLORAL” SH.P.K” SH.P.K me Nuis J68319510L, skualifikohet.***

## **II- Operatori Ekonomik “LURIMI” SH.P.K me Nuis J68403912U.**

**Se pari**, nuk ploteson kriterin 1, ne lidhje me Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit, sipas shtojces 7 dhe sipas shtojces 8.

Kvo, veren se ne shtojcen 7, parashikohet si me poshte:

### ***1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT***

*Ofertuesi deklaron se:*

---

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

**Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Gjithashtu KVO, verën se bazuar në pikën 1 dhe 2 (c), të nenit 26, të VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parshikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla,

2. formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

, per te permbushur këto kritere duhet të paraqitet Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit të operatoreve ekonomike në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Operatori Ekonomike nuk ka plotësuar te dhenat per **personin/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik**, ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ne kreun A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, ne seksionin ne lidhje me informacionin dhe deklarimin ne zbatim te pikes 2(c) te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, ne te cilen duhet te deklarohet si me poshte: “*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së*”.

Per me teper referuar vendimit nr. 537/2019, date 14.08.2019, edhe Komisioni I Prokurimit Publik, ka mbajtur te njejtin qendrim ne te cilin ka vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues per kete vendim pikerisht, sepse nuk ka plotësuar e deklaruar te gjithë emrat sipas formatit te shtojcës 8 te DST. Konkretisht, KPP ne kete vendim shprehet:... ***“KPP gjykon se në rastin konkret nuk jemi ne kushtet e devijimit të vogël apo pamundësisë së autoritetit kontraktor për të verifikuar se kush është ortaku i shoqërisë Marketing&Distribution shpk, por jemi përballë mosplotësimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese. Format i shtojcës e kërkon që të citohen emrat konkretë të të gjithë subjekteve të përmëndur më sipër në mënyrë nominale ndryshe shtojca do të ishte konceptuar në mënyrë të përgjithshme. Për këtë shkak shtojca e dorëzuar nga anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë 11 Marketing&Distribution shpk nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar”***.

Sa me lart duke qene se formati i shtojcës 8, e kërkon që të citohen emrat konkretë të të gjithë personave në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik në mënyrë nominale ndryshe shtojca do të ishte konceptuar në mënyrë të përgjithshme. Për këtë shkak shtojca nr. 8, e dorëzuar nga OE nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar, duke mos permbushur kete kriter.

**Se dyti**, KVO verën se OE ka deklaruar ne kundërshtim me formatin e miratuar ne DST, ne seksionin *B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura*.

---

I. KVO veren se ne formatin e miratuar ne DST-ne e procedures se prokurimit me objekt “Blerje fidanesh per pyllezim, peme dhe lule per gjelberim”, ne seksionin **B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura** parashikohet se:

| <b>Deklarata</b>   | <b>Përgjigje</b>     |
|--|----------------------|
| Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:  |                      |
| 1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklaratë;   | <b>Po [ ]</b>        |
| 2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;   | <b>Po [ ]</b>        |
| 3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;  | <b>Po [ ]</b>        |
| 4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;  | <b>Po [ ]</b>        |
| 5. Për efekt të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:<br>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti Kontraktor;<br>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës . | <b>Po [ ]</b>        |
| 6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;   | <b>Po [ ] Jo [ ]</b> |
| 7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më  | <b>Po [ ] Jo [ ]</b> |

|   |                      |
|---|----------------------|
| <i>shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit).</i>  |                      |
| <i>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</i><br><i>a) çmimet;</i><br><i>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</i><br><i>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</i><br><i>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</i> | <b>Po [ ] Jo [ ]</b> |
| <i>9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.</i>  | <b>Po [ ] Jo [ ]</b> |
| <i>10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.</i>  | <b>Po [ ] Jo [ ]</b> |

II. Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, ne Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur nga OE në seksionin **B: DEKLARATA, Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura, në pikën 3 dhe 4** deklarohet se:

|  |  |
|--|--|
| <i>3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;</i> | <b>Po [ ] Jo [ X ] Kete deklarate e firmos administratori dhe nuk eshte autorizuar asnje individ tjeter jashte kompanise</b> |
| <i>4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga</i>                        | <b>Po [ ] Jo [ X ] Oferta do të paraqitet dhe pergatitet nga administratori dhe nuk eshte</b>                                |

|   |   |
|---|---|
| <i>ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;</i> | <i>autorizuar asnje individ tjetër jashtë kompanisë</i> |
|---|---|

- III. KVO konstaton se Operatori Ekonomik nuk i është përmbajtur formatit të miratuar në DST-ne e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje fidanesh për pyllëzim, peme dhe lule për gjelberim”, në plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në seksionin **B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura, në pikën 3 dhe 4**, duke nderhyrë në formatin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.
- IV. Për më tepër konstatohet se formati i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të miratuar në DST-ne procedurës së prokurimit me objekt “Blerje fidanesh për pyllëzim, peme dhe lule për gjelberim”, për pikat 3 dhe 4 të seksionit **B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**, parashikon si përgjigje vetëm **“Po [ ]”** e cila duhet të konfirmohet me shenim brenda kllapave, duke mos parashikuar asnjë formë tjetër përgjigje apo deklarimi.
- V. KVO mban në konsideratë se në nenin 14, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se: *“APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit, për çdo lloj procedure prokurimi sipas nenit 41, të LPP-së, dhe çdo tip kontrate”*.
- VI. Po ashtu KVO mban në konsideratë se formati i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit për procedurat e prokurimit “E hapur e thjeshtuar/ Mallra” është miratuar me vendimin nr. 03, datë 09.06.2021 *“Për miratimin e dokumentave standarde të tenderit për mallra, pune, shërbime për procedurën e prokurimit “Procedure e Hapur e thjeshtuar”, e korigjuar me anë shkresës Nr. 2416/6, datë 14.06.2021 dhe asnjë autoritet kontraktor apo operator ekonomik nuk mund të modifikojë apo të ndryshojë formularet e miratuar në DST.*
- VII. Gjithashtu në dokumentat standarde të tenderit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje fidanesh për pyllëzim, peme dhe lule për gjelberim”, në seksionin I, udhëzime për Operatorët Ekonomike, në pikën B/4 përcaktohet se *“Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqëruar duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar”*.

Nisur sa më lart, KVO thekson se në këto rast jemi përballë mosplotësimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese.

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur në nenin 76, pika 3/a dhe në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e



profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “LURIMI” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

***Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “LURIMI” SH.P.K me Nuis J68403912U, skualifikohet.***

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE “A l b G a r d e n” Shpk, me adrese Lagjja “Skenderbeg”, godine private 1 kateshe në superstraden Lezhe - Shkoder, km-1, Lezhe, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 3,185,058 (tre milion e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëdhjetë e tete) Lek pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**KRYETARI**  
**Pjerin NDREU**